

KAPËRCYELLI I ÇËSHTJES SHQIPTARE

Çështja shqiptare në kapërcyell drejt shekullit të 21-të paraqitet si një ndër problemet më interesante e ndër më të ndërlikuarat në skenën e historisë bashkëkohore europiano-lindore. Interesi ndaj saj qëndron në faktin se shqiptaret po kalojnë aktualisht në një proces rilindjeje të dytë në të gjithë hapesirën etnike, një proces të ripërcaktimit plotësues të identitetit etno-kulturor, një proces nacional-demokratik me karakteristika të veçanta ndër shtetet ku bëjnë pjesë, ndër procese çlirimtare e shtet-formuese mjaft të ndërlikuara dhe të veçanta dhe momentalisht, është ndër popujt më të përfshirë nga procesi i migrimeve të brendshme dhe të jashtme.

Çështja shqiptare paraqitet e ndërlikuar, për arsyen e ndërthurjes dhe përplasjes në të të mjaft faktorëve me karakter të brendshëm dhe të jashtëm, ndër të cilët mund të përmendim konceptimin e ndryshëm të shqiptarizms nga segmentet përbërës të popullsisë, shpërpjesëtimet kulturore dhe arsimore midis krahinave e zonave rurale dhe urbane si rezultat zgjatjes së periudhës mesjetare (sidomos në zonat rurale të Republikës së Shqipërisë dhe territoret etnike lindore Gostivar, Dibër, Tetovë) deri në fillim të viteve 90-të, pozitat e ndryshme gjeopolitike të pjesëve të Shqipërisë etnike, ballafaqimin e shqiptareve me popuj egërsisht të përcaktuar qartë në nacionalizmin dhe orientimin e tyre kulturor identifikues, dhe me një politike globale të Fuqive, e stabilizuar ngurtësisht në parimet dhe rregullat e saja themelore, para kësaj rilindjeje të dytë të shqiptarëve.

Populli më i vjetër i Ballkanit, etnikisht homogjen në tërësinë e shtrirjes së tij territoriale dhe origjinën historike, paraqitet gjeopolitikisht sot i ndarë në një shtet amtar, dhe në tre shtete të tjera fqinje me te. Nga pikpamja organizative nacionale atij i ka munguar ekzistenca e një qendre të përhershme drejtuese për orientimin e saktë dhe natyral të levizjes dhe ideologjisë udhërrëfyese

Editorial

patriotike. Roli drejtues që patën në këtë drejtim për një periudhë relativisht të gjatë inteligjenca shkodrane apo korçare, apo në vijim, qarqet intelektuale qytetare të instaluar në Tiranë në vitet e mbretërisë shqiptare, u çrrenjos barbarisht nga diktatura gjakatare e Enver Hoxhës. Të gjendur në sferat tërheqëse të kulturave nga më të përkundertat, në kushtet e niveleve elementare të arsimit kombëtar dhe të një prapambetje ekonomike-shoqerore të konservuar kryesisht nga Perandoria Osmane, por edhe nga pushtetet komuniste, segmentet e paftilluara nacionalisht e kulturalisht të këtij kombi, kanë rënë herë mbas here pré e deformimeve apo asimilimeve kulturore dhe janë bërë në ndonjë rast edhe rezervë shërbyese e pavetëdijshme e kulturave krejtësisht të ndryshme me atë të origjinës iliro-arbnore dhe të bazamentit të vet natyrore evropian. Një gjë e tillë është shprehur në konceptimet e ndryshme të aleatëve kulturorë dhe strategjikë, në thelbin e vlerësimit të ideologjise dhe lëvizjes kombëtare, në shtrembërimet e realiteteve dhe të të vertetave historike të hidhura, në vectorientimin dhe vetgrykimin e pjeseve të këtij populli, në mosgjetjen e gjuhës së përbashkët për ndërtimin e bazamenteve themelore të ekzistencës së një shteti dhe të një kombi modern, pra në mosparaqitje të njësuar kulturalisht dhe strategjikisht, para një bote të ftohte para fatkeqësive të kaluara dhe të së ardhmes sate si komb.

Karakterizime të tilla detyrohemi t'i vemë në dukje jo se e shikojmë të pashpresë procesin shumë të dëshiruar të njësimin nacional e kulturor të shqiptarëve, përkundrazi, sepse e vlerësojmë si urgjent, plotësisht të mundshëm dhe në momentin e duhur. Dy janë sfidat kryesore që e bëjnë urgjent këtë proces: së pari proceset destabilizuese juridiko-institucionale që po kalon Republika e Shqipërisë; së dyti procesi çlirimtar që po kalon Republika e Kosovës. Këtyre dy situatave shqiptarët mund t'ia dalin mbanë vetëm nëqoftëse i përgjigjen me qëndrime të njësura dhe të mirorientuara.

Mbi njësimin kulturor të shqiptarëve

Pikësëpari duhet ta kemi përfundimisht të qartë se shqiptaret do të mund të kenë rezultatet e dëshiruara në përpjekjet e tyre për afirmim serioz kombëtar dhe ndërkombëtar, vetëm nëse

Editorial

punojnë për të realizuar njësimin kulturor, bazuar në një filozofi kombëtare të përbashkët, çfarë nënkupton kulturen iliro-arbnore si pjesë të kulturës europiane. Fatkeqësisht, jo të gjitha segmentet përbërëse të shqiptarizmit e kanë të qartë këtë bazament kulturor evropian dhe ndodhen në pozicione të çorientuara ftilimi. Për arsye të pamjaftueshmërisë së formimit nacional dhe të përzierjes së elementeve të popullsive migratore të ardhura në shekujt e kaluar nga Azia apo Bosnja me popullsinë vendase shqiptare, ende ekzistojnë edhe sot segmente popullsie në trevat tona etnike me nostalgji otomaniste, nostalgji që edhe në Turqinë moderne është e reduktuar në një pakicë të papërfillshme. Që shqiptarët të mund të bëjnë hapin e parë të madh drejt unifikimit kulturor dhe të qëndrimeve të tyre strategjike orientuese, duhet të bijnë dakord përfundimisht në atë që është tashmë e sterprovuar nga historia: se, **pushtuesi otoman ishte ai që i kërcënoi identitetin etno-kulturor, i shkatërroi edhe pjesë të qytetritimit antiko-mesjetar dhe i vuri në dyshim ekzistencën e tij fizike.** Ndarja përfundimtare me këtë trashëgimi të padëshiruar e poshtëruese është kushti themelor i domosdoshëm i përparimit të përbashkët të të gjithë shqiptarëve. Shqiptarët janë natyralisht vëllezër vetëm në mes tyre, pavarësisht nga katër besimet fetare, sepse ata i bashkon origjina racore, flamuri krenar, gjuha shqipe, kultura europiane iliro-arbnore, atdheu homogjen etnik, "feja" e tyre e përbashkët-shqiptaria, përpjekja e pareshtur për bashkimin e trojeve etnike shqiptare, përpjekja për të krijuar institucione të civilizuar demokratike perëndimore, krijimi i infrastrukturave moderne të brendshme dhe të jashtme. Çdo përpjekje për përfaqësim të ndryshëm të shqiptarëve dhe ideologjisë së tyre nacionale do të ketë si pasojë direkte një përçarje dhe dizintegrim të pariparueshëm mes atyre grupimeve kulturore që krijoi përdhunisht dhe artificialisht pushtuesi aziatik nga tërësia homogjene e popullsisë arbnore. Diferencat kulturore duhet t'i ngushtojmë sa më shumë të jetë e mundur sot, sepse nesër do të jetë vonë, mbasi ato mund të mos jenë më vetëm diferenca. Ekzistojnë edhe sot disa të ashtuquajtur "intelektualë" shqiptarë që "nuk e dinë" se Lëvizja Rilindëse Kombëtare ka qenë e ndarë nga rrymat konservatore otomaniste, pikërisht në veçimin kulturor që rilindasit e mëdhenj i bënë shqiptarëve prej

Editorial

otomanëve, që i bënë shqiptarëve nga turqit, grekët serbët etj. Këtë veçim kulturor ata nuk e bënë artificialisht por të bazuar në të verteten historike, në origjinën kulturore të shqiptarëve në ftilimin e mendjes së popullit për këtë prejardhje autoktone dhe europiane të dhunuar barbarisht nga pushtuesi aziatik. Jo të gjithë shqiptarët e kanë të qartë se besimet e lira fetare dhe respektimi i feve të veçanta, janë ndër kushtet themelore të ekzistencës së demokracive perendimore, janë ndër parimet themelore mbi të cilat baballarët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare orientuan veprimtarinë e tyre patriotike. Jo të gjithë shqiptarët e kanë të qartë se bashkëkombasit e vet, besimtarë të Krishtit apo të Muhametit qofshin, janë bij të këtij dheu të lashtë, bij të nënës Shqipëri, besnikë të amanetit të të parëve. Duhet ta kemi të qartë se shteti shqiptar ka lindur është zhvilluar (përjashtohet këtu periudha diktatoriale komuniste) në ndërtimin e vet institucional, si shtet laik, d.m.th. jo teokratik. Është detyrë urgjente patriotike e intelektualëve shqiptarë të marrin përsipër rolin e ndërgjegjësuesit ndaj nukleve të pa ftilluara nacionalisht të këtij kombi. Mund të marrim shpërblime braktisëse nga Perëndimi dhe mallkimin e brezave të ardhshëm, nëqoftëse do të lejojmë përsëritjen e daljes se turmave të pavetëdijshme të Shqipërisë Lindore (Gostivar) me parulla që të kujtojnë fshatarët "kryengritës" të Haxhi Qamilit, nëqoftëse nuk do t'i varrosim me ritet shqiptare martirët e kombit në Kosovë, nëqoftëse do të vazhdojmë të klasifikojmë si të drejta manipulimet masive të elektorateve të caktuara shqiptare bazuar ndër ndasi fetare, siç ka ndodhur në ndonjë qytet të Shqipërisë në zgjedhjet lokale të tetorit 1996. Sot, më shumë se kurrë është bërë i domosdoshëm dhe urgjent izolimi dhe demaskimi i atyre grupimeve pseudointelektuale të financuara nga burime të dyshimta, që po hedhin baltë mbi figuren e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit dhe gjakun e derdhur arbnor ndaj pushtuesit otoman, që po kërkojnë me turp të fshijnë nga kujtesa e tronditur e këtij populli viganët martirë të kulturës kombëtare, që mundësuan ndër vitet e errëta të terrorit osmanlli në Arbëri, ruajtjen e gjuhës së pastër shqipe, themelimin e shkollës kombëtare, themelimin e letërsisë shqiptare, ruajtjen e identitetit nacional e kulturor të pastër shqiptar, përvijimin e orientimit natyral strategjik të Shqipërisë (ndër të

Editorial

tjera, duke bërë heronj individë të panjohur dhe të fshirë nga historia për shkak të shërbimeve politike dhe kulturore që i kanë bërë pushtuesit të dhunshëm oriental). Nostalgjikët e rinj otomnistë shqiptarë (një klan individësh të dështuar, kryesisht fshatarë, të "përgatitur" gjatë epokës komuniste, të "kalitur" nëpër labirintet e servilosjeve të mbijetesës nëpër zyrat partiako-police-ske të diktaturës), janë të gatshëm madje të harrojnë dhe të fshijnë një epokë të tërë identifikuese shqiptare parasllave dhe paraturke të Kosovës, kur kjo krahinë ishte për shekuj me radhë njësi e veçantë kishtarë dardano-arbërore, dhe kur popullsia shqiptare i rezistoi mrekullisht të gjitha pushtimeve sllave. E gjitha kjo, vetëm e vetëm që të pranohen tezat e tyre të paskrupullta dhe qesharake për të cilat paguhen. Dhunimeve e përdhosjeve të tilla jo vetëm nuk duhet t'u krijohen hapësira, por ato duhet të shtypen me forcen e shoqërisë madje edhe të ligjit, sepse mund të jenë një precedent i rrezikshëm për ndarjen në mes atyre shqiptarëve që e kanë definitivisht të përcaktuar dhe të qartë rrugen kombëtare drejt së ardhmes europiane dhe të tjerëve që këtë të ardhme në Europë e konceptojnë nëpërmjet kalimit ndër shkretëtira të pafund.

Mbi procesin e çlirimit të Republikës së Kosovës.

Momenti që po kalojmë përbën më vendimtarin për fatet e ardhme jo vetëm të trungut verilindor shqiptar, përkatësisht Republikës së Kosovës, por edhe të kombit shqiptar në përgjithësi. Zgjidhja e shpejtë dhe proshqiptare e këtij konflikti do të thotë fuqizim i faktorit shqiptar në Ballkan, dobësim i pozitive sllave ruse në këtë rajon, kalim përfundimtar të Shqipërisë dhe shqiptarëve në një botë moderne europiane së cilës u përkasim, vendosje përfundimtare, për rrjedhojë në këtij pozicionimi, të strukturave dhe institucioneve politiko-juridike të qytetërimit perendimor demokratik, dominim përfundimtar në planin e brendshëm i forcave dhe grupimeve shoqërore me ndërgjegje të formuar nacionale, demokratike, qytetare dhe intelektuale, një rënie përfundimtare nga skena politike shqiptare e klanit antikombëtar komunisto-fshatar jug-perendimor dhe mikroklanit anarkisto-fshatar berishian.

Zgjidhja e drejtë dhe proshqiptare e konfliktit në Kosovë

Editorial

ndërvaret nga një varg faktorësh me karakter të brendshëm dhe të jashtëm. Për shqiptarët si komb në tërësi është i domosdoshëm dhe urgjent përfundimi i proceseve të unifikimit të përfaqësimeve politiko-diplomatiko-ushtarake. Kjo kërkesë i përket në radhë të parë Republikës së Kosovës. Ajo shtrohet si nga opinioni përparimtar shqiptar ashtu edhe nga aleatët e jashtëm strategjikë të popullit tonë. E shprehur më qartë një gjë e tillë do të thotë shkrirje e përfaqësimeve politiko-institucionale me ato ushtarake, konstituim i plotë organizativ i institucioneve shtetërore dhe ushtarake, afrim i qarqeve politike ndaj qarqeve ushtarake dhe pranim pa kushte i njëri-tjetrit. Shqiptarët e Kosovës nuk duhet të harrojnë eksperiencën e fitores kroate në luftën me serbët në gjetjen e udhëheqësisë së njësuar politiko-ushtarake, që u karakterizua nga vendosmëria maksimale në përdorimin e mjeteve ushtarake në radhë të parë dhe politiko-diplomatike në radhë të dytë për mposhtjen e egërsisë së bishës komuniste serbe. Fatkeqësisht shqiptarët tanimë duhet ta venë theksin në zgjidhjen ushtarake, jo vetëm sepse ata i kanë plotësuar të gjitha detyrimet e tjera të moderuara si palë, por kryesisht se ata gjinden momentalisht përballë një agresioni barbar që ka si objektiv themelor pastrimin etnik të shpejtë të Kosovës nga shqiptarët. Shqiptarët gjenden kështu përpara një sfide historike të cilen duhet ta përballojnë me mobilizim trupor ushtarak. Nga kjo nevojë për mbijetese fizike, ka lindur dhe është zhvilluar “një foshnjë”, “një fëmijë” që po bëhet shumë shpejt sokol shqiptar i pamposhtur - Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Luftëtarët e UÇK-së i perkasin genit dhe segmentit më të pastër, më burrëror dhe më të pamposhtur të shqiptarizmit. Adem Jasharët po e tregojnë çdo ditë e më shumë se janë stërnipër të denjë të martirëve kristianë dardanë Flori dhe Lauri, Gjergjit të Kastriotëve, Pjeter Bogdanit, Hasan Prishtinës, Isa Buletinit, Bajram Currit, Azem Galicës, Shtjefen Gjeçovit, e dhjetra e dhjetra martirëve të tjerë të njohur e të panjohur kosovarë. UÇK-ja për të përfunduar me sukses misionin e saj çlirimtar duhet të përkryejë sa më shpejt procesin e organizimit të mirëfilltë të hierarkisë ushtarake, e cila të jetë e përgjegjshme përballë një udhëheqësie politike. Përvoja ka treguar domosdoshmërinë e gjetjes në mënyrë të shpejtë të një udhëheqësi ushtarak kjo të orientuar edhe politikisht,

Editorial

të cilit duhet t'i binden më pas ushtarakisht të gjithë shqiptarët e angazhuar për çlirimin e Republikës së Kosovës nga robëria serbe. Lufta kërkon mobilizim disiplinë dhe bindje ushtarake kur është fjala për çështjen e shenjtë kombëtare. Koha gjithashtu shtron si domosdoshmëri një përgjegjësi më të madhe politiko-ushtarake të faktorit shqiptar në Kosovë. Kjo përgjegjësi do të arrihet kur udhëheqësia legjitime politike e Kosovës dhe udhëheqësia ushtarake të kenë një zë të vetëm. Kjo shkrimje e domosdoshme nuk mund të jetë artificiale, mekanike dhe formale, por një njësim organik, i bazuar në një platformë programore të koordinuar politiko-ushtarake që ka si objektiv themelor pavarësinë e Republikës së Kosovës, dhe mjet për arritjen e këtij qëllimi tashmë, atë ushtarako-diplomatik. Është krejtësisht e arësyeshme dhe e ndershme që udhëheqësia politike kosovare të pranojë UÇK-në si faktor themelor në arritjen e objektivit nacional. Është nder, detyrë dhe mençuri për udhëheqësinë ushtarake të UÇK-së, që pasi të sigurohet për ruajtjen e qëllimit dhe të pozitës së saj aktuale, të integrohet në strukturat e shtetit shqiptar në Kosovë. Një afrim i tillë është krejtësisht i mundshëm pasi UÇK-ja ka sprovuar tashmë vetveten se është ushtri e një populli të qytetëruar që njeh standardet ndërkombëtare të sjelljes ushtarake, se është krejtësisht larg veprimeve terroriste apo fundamentaliste. Flamuri i vetëm i tyre është ai kombëtar shqiptar, feja e tyre e vetme është shqiptaria. Këto përbëjnë garancitë më të mëdha jo vetëm për Presidentin Rugova dhe klasën politike kosovare, por edhe për komunitetin ndërkombëtar që po e vlerëson përherë e më shumë në një drejtim të tillë faktorin UÇK. Në këtë kuadër merr një rëndësi të posaçme për faktorin shqiptar në Kosovë në tërësi, hedhja poshtë në mënyrë deklarative të ofertës më të fundit për ndërmjetësim në mes shqiptarëve dhe komunitetit ndërkombëtar, të bërë nga ministri i jashtëm iranian. Pranimi, madje edhe mos demaskimi i një oferte të tillë djallëzore do të mund të ketë pasoja vetshkatërruese brënda kampit të kombit shqiptar, dhe një stimul më shumë për Serbinë për vazhdimin e etnocidit të pandalur në Kosovë.

Konstituimi i parlamentit të zgjedhur demokratikisht me voten e popullit me 22 mars nuk përbën një hap bosh, përkundrazi është një veprim i vonuar që duhet ndërmarrë menjëherë.

Editorial

Në këtë drejtim janë të pamotivuara politikisht dhe historikisht qëndrimet kundërshtuese të disa njërëzve kokëfortë në Kosovë, që ose për miopi politike, ose për karrierizëm synojnë të shfrytëzojnë momentin delikat për të ridalë në skenë. Duhet të kihet përfundimisht parasysh se komuniteti ndërkombëtar njeh si udhëheqës legjitim të shqiptarëve në Kosovë Presidentin Ibrahim Rugova. Ky faktor ka filluar të llogarisë si faktor të rëndësishëm jo terrorist në skenën kosovare UÇK-në. Madje, diplomacia amerikane është duke punuar dhe kërkuar një shkërrirje të këtyre dy faktorëve shqiptarë në një zë të vetëm. Për t'u bërë i pranueshëm në këtë botë të ftohët për shqiptarët, Rugovës dhe stafit të tij u është dashur vite të tëra provimesh përgjegjshmërie para mjeshtërve më të mëdhenj të politikës ndërkombëtare. A do të ishte e arsyeshme që kjo njohje e njeriut të parë të shtetit shqiptar në Kosovë të pasohej nga njohja e organit legjitim të popullit shqiptar, pra Parlamentit? A është e arsyeshme që Kosova të presë derisa të bëhen të pranueshëm për Perëndimin si udhëheqës edhe Demaçi, Qosja, Hyseni e të tjerë? Jo, shqiptarët nuk kanë kohë dhe arsye të presin më tej derisa të zgjidhin hasmëritë personale politikanët e tyre meskinë. Foshnjet e nënat e Kosovës presin kthimin në trojet e tyre, djemte nga malet presin të kthehen fitimtarë ndër qytete. Vuajtjet e tyre mund të shkurtohen nëqoftëse politikanët shqiptarë paraqiten të njesuar në konstituimin e organeve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe në llogaritjen e saktë dhe të thjeshtë të hapave që duhen ndërmarrë:

1-Duhet të konstituohet sa më shpejt Parlamenti i Republikës së Kosovës; Ky Parlament mund të funksionojë dhe të kryejë misionin e vet vetëm nën mbrojtjen e UÇK-së dhe në zonat e kontrolluara nga ajo.

2-Brënda 20 ditësh duhet krijohet dhe aprovohet qeveria e Republikës së Kosovës që nuk mund të jetë gjë tjetër veçse qeveri e shpëtimit kosovar me përbërje të gjërë nga të gjithë personatitetet e jetës politike e intelektuale kosovare, pozitive opozitive;

3-Menjëherë të pranohet UÇK-ja si ushtri e Republikës së Kosovës dhe udhëheqësia e ministrisë së mbrojtjes t'u jepet komandes se UÇK-së;

4-Fondi "Vendlindja thërret" të mbahet i paprekur dhe të admi-

Editorial

nistrohet vetëm si fond i Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo do të kërkojë një organizim përfekt të administrimit financiar, bazuar në përgjegjshmëri ligjore lufte;

5-Vendosja në krye të ministrisë së jashtme të një personi të aftë, që njeh mirë jo vetëm diplomacinë por edhe historinë e popullit të tij.

Ora e madhe për shqiptarët ka arritur. Serbia në Kosovë është tashmë një shtet i vdekur. Dërmimi i saj atje varet kryesisht nga ne, forca e mençuria dhe mobilizimi jonë.

Situata dhe zhvillimet e fundit në Republikën e Kosovës janë një thirrje mendjeje për popullin shqiptar dhe sidomos për klasën politike shqiptare në shtetin amë, për të lënë prapa politiken klanore bizantino-komuniste dhe ndërtimin e strategjisë dhe taktikës së administrimit të problemit kombëtar shqiptar.

Është i një rëndësie themelore stabiliteti afatgjatë i shtetit amë, Republikës së Shqipërisë. Ky stabilitet kërkon forcimin e veprimtarisë së shtetit ligjor, depolitizimin e menjëhershëm të institucioneve që përfaqësojnë ligjin dhe shtetin, forcimin përfundimtar të rendit publik dhe përfundimin e shpejtë dhe prioritar të procesit të riorganizimit të strukturave mbrojtëse ushtarake në Veriun e Shqipërisë. Asnjë ndihmë nuk mund t'i jepet trungut verilindor shqiptar nëqoftëse Shkodra dhe Shqipëria veriore do të mbeten prë e krimit të jashtëm dhe të brendshëm, një hapësirë pa asnjë strukturë mbrojtëse ushtarake dhe siguruese, një zonë tejet e varfër dhe e harruar, domen i injorancës dhe i politikanëve meskinë.

Përfaqësimi diplomatik i çështjes shqiptare duhet të ketë një përmbajtje unike. Shqipëria dhe Kosova dhe diplomacitë e tyre përkatëse, duhet të kapin momentin dramatik në Kosovë dhe t'u kujtojnë demokracive perendimore se kur një fuqi shtetërore asgjëson fizikisht nënshtetasit e vet civilë të një etnie tjetër atëherë kemi të bëjmë me etnocid të një shteti pushtues. Më shumë se kurrë sot diplomacia shqiptare ka arsye të kërkojë ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare dhe një "Dayton 2" për Republikën e Kosovës. Kosova nuk është dhe nuk ka qenë kurrë një çështje e brëndshme e Serbisë. Përfundimi nuk duhet të pranojë sot regrese të dhunshme kushtetuese. Shqipëria duhet të parandalojë përfundimisht njohjen e Serbisë dhe të Republikës

Editorial

së mbetur Jugosllave sepse në rast të kundërt do të kemi edhe njohjen përfundimtare të integritetit të Serbisë mbi Kosoven dhe varrosje të çështjes së trungut verilindor shqiptar. Nëqoftëse në tryezat diplomatike do të pranohet të diskutohet për shqiptarët e Kosovës duke reduktuar problemin në një çështje pakice etnike, kemi pranuar indirekt sovranitetin e Serbisë mbi Kosoven. Por kur të sqarojmë mbi fakte shkencore e historike se Kosova është djepi i krishtërimut shqiptar, përbën 45% të trungut etnik shqiptar dhe ndodhet në vijimësi etno gjeografike me trungun amë, atëhere kemi bërë hapin e parë të vogël drejt trajtimit të orientuar të çështjes. Trajtimi ndërkombëtar i problemit të Kosovës nuk duhet të bëhet jashtë historisë së krijimit dhe të dezintegritimit të shtetit shumëkombësh Serbo Kroato Slloven, përkatësisht më vonë ish- RSF të Jugosllavisë. Kjo do të thotë ndër të tjera që të njihet ish-statusi kushtetues i Kosovës si pjese përbërëse e barabartë e ish Federatës jugosllave, dhe e drejta e barabartë e kësaj ish njësie federative për vetvendosje deri në shkëputje. Në këtë mënyrë Kosova ka po aq të drejtë konstitucionalisht dhe në bazë të së drejtes ndërkombëtare sa edhe Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Maqedonia për vetvendosje e shkëputje nga shteti artificial jugosllav.

Kurrë më shqiptarët nuk duhet të druhen të kërkojnë dhe të mbrojnë të drejtat e tyre. Përfundimisht shteti i tyre amë duhet të dalë nga përvujtësia dhe inferioriteti ndërkombëtar. Përfundimisht shqiptarët fatkeqë dhe klasa e tyre politike postkomuniste duhet të kuptojnë se përfundimi i ndërtimit të shtetit të tyre ligjor, demokratik, laik dhe europian është e vetmja rrugë për një të ardhme të sigurtë të Shqipërisë europiane dhe Kosovës së lirë. Autoriteti ndërkombëtar i një shteti varet jo nga madhësia e tij por nga serioziteti i demokracisë, institucioneve dhe i kauzës ndërkombëtare që mbron.

Shkodër 14.07.1998

Dr Romeo Gurakuqi